



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20084 Prot

Lezhë, më 21.12.2022

**VENDIM**

Nr 135, Datë 20 . 12 . 2022

**Për një shtesë e ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të akorduar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe shkresës së Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.22369, datë 05.12.2022 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2022”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

1. Miratimin e një shtese dhe ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2022 në shumën 64,158,000 lekë, fond i cili është akorduar me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022.

2/2-Të shtohen shpenzimet në shumën 64,158,000 lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

• Pakësohet :

- Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604 në shumën 64,158,000 lekë.

• Shtohet :

-Gr.00, Prog.04520, Kap.01, Art.231 në shumën 35,800,000 lekë, për këto objekte: a.Sistemim, asfaltim rrugë rurale në shumën 25,253,981 lekë, b.Sistemim, asfaltim rruga “Hydajet Lezha” në shumën 1,035,244 lekë, c.Sistemim, asfaltim rruga “Çamëria” në shumën 9,510,775 lekë.

-Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.602 në shumën 722,151 lekë (karburant-384,942 lekë, vendime gjykatë-337,209 lekë).

-Gr.00, Prog.01120, Kap.01, Art.602 në shumën 268,216 lekë (karburant-160,696 lekë, mirëmbajtje automjetesh-107,520 lekë).

-Gr.00, Prog.03140, Kap.01, Art.602 në shumën 31,160 lekë (karburant-31,160 lekë).

-Gr.00, Prog.03280, Kap.01, Art.602 në shumën 678,891 lekë (karburant-202,971 lekë, mirëmbajtje automjetesh-475,920 lekë).

-Gr.00, Prog.04240, Kap.01, Art.602 në shumën 3,825,576 lekë (karburant–3,019,836 lekë, mirëmbajtje automjetesh–805,740 lekë).

-Gr.00, Prog.04520, Kap.01, Art.602 në shumën 11,203,982 lekë (karburant–1,595,549 lekë, mirëmbajtje automjetesh–4,513,500 lekë, materiale ndërtimi–5,094,933 lekë).

-Gr.00, Prog.05100, Kap.01, Art.602 në shumën 39,783 lekë (karburant–39,783 lekë).

-Gr.00, Prog.05200, Kap.01, Art.602 në shumën 117,641 lekë (karburant–117,641 lekë).

-Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.602 në shumën 95,242 lekë (karburant–18,922 lekë, mirëmbajtje automjetesh–76,320 lekë).

-Gr.00, Prog.06260, Kap.01, Art.602 në shumën 63,682 lekë (karburant–63,682 lekë).

-Gr.00, Prog.06440, Kap.01, Art.602 në shumën 4,992,259 lekë (karburant–56,471 lekë, materiale elektrike–4,935,788 lekë).

-Gr.00, Prog.08220, Kap.01, Art.602 në shumën 91,417 lekë (karburant–22,957 lekë, mirëmbajtje automjetesh–68,460 lekë).

-Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.602 në shumën 5,402,281 lekë (karburant–689,272 lekë, materiale ndërtimi–4,713,009 lekë).

-Gr.00, Prog.09230, Kap.01, Art.602 në shumën 791,136 lekë (materiale ndërtimi–791,136 lekë).

-Gr.00, Prog.10430, Kap.01, Art.602 në shumën 34,583 lekë (karburant–14,783 lekë, mirëmbajtje automjetesh–19,800 lekë).

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**

**NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 949/ Prot.

Lezhë, më 22 .12 .2022

Prot 20084/  
Dt. 22.12.22  
Fim K. B

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Aktit Normativ nr 17, datë 01.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.135, datë 20.12.2022 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të akorduar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ".

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

